





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUÇITRN

DATE:	28 09 2020
PËR:	KPF dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
PROPOZUES:	Xhafer Tahiri Kryetar i Komunës së Vushtrrisë 
HARTUES:	Blerim Zhabari 
TEMA:	Akt – përcjellës lidhur me Draft Strategjinë komunale për komunikim 2021-2023

Të nderuar,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkëngjitur Draft Strategjinë komunale për komunikim 2021-2023 të Komunës së Vushtrrisë - (shqyrtimi i parë).

Hartimi i kësaj Draft strategjie është bërë nga Udhëheqësi i Zyrës për komunikim me publikun në bashkëpunim me një ekspert të jashtëm të angazhuar nga programi USAID-TEAM.

Ky dokument është një dokument origjinal i cili në fakt është punuar në fund të vitit të kaluar. Gjatë hartimit të tij është bazuar në dy hulumtime edhe të opinionit të punëtorëve të Komunës lidhur me Komunikimin e brendshëm si dhe kënaqshmërinë e tyre në punë.

Me respekt!

2020

STRATEGJIA KOMUNALE PËR KOMUNIKIM 2021-2023

STRATEGJI E INTEGRUAR E KOMUNIKIMIT TË
BRENDSHËM DHE KOMUNIKIMIT TË JASHTËM NË
ADMINISTRATËN KOMUNALE



SFONDI

Historiku

Komuna e Vushtrrisë, ose Vicianumi siç është quajtur përpara sipas emrit të vjetër ilir, është lokalitet antik, që daton qysh nga mesjeta, edhe para Perandorisë Romake, përkatësisht që nga koha e dardanëve. Viciani në fund të shekullit I p.e.s. pushtohet nga Perandoria Romake. Gjatë periudhës së pushtimit romak Viciani kishte arritur një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe kulturor. Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, Viciani mbeti në kuadër të Bizantit. Në kohën e ndarjes së krishterimit më 1054 në katolicizëm dhe ortodoksi, pjesa më e madhe e popullatës së Vicianës ishte katolike. Në shekullin XIV Perandoria Osmane pushtoi Ballkanin e me këtë edhe Vushtrrinë. Gjatë shekujve XV–XVIII, Vushtrria ishte ndër qytetet më të mëdha në Ballkan e për rrjedhojë edhe qendër e sanxhakut. Gjatë Luftës së Parë Botërore, përkatësisht gjatë viteve 1915–1918, Vushtrria u pushtua nga Austro-Hungaria.

Profilli

Komuna e Vushtrrisë shtrihet në pjesën veriore të Kosovës. Në veri kufizohet me Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajin. Komuna e Vushtrrisë shtrihet ndërmjet dy qendrave të mëdha urbane Prishtinës dhe Mitrovicës.

Komuna e Vushtrrisë është qendër me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, si dhe falë tokës pjellore e cila ofron kushte të volitshme për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore. Komuna e Vushtrrisë prinë në prodhimin dhe përpunimin e patates. Në komunën e Vushtrrisë, po ashtu, edhe sektori privat është bartësi i zhvillimit ekonomik. Sektorët më të zhvilluar janë: bujqësia (ekstensive), blegtoria (me numër relativisht të madh të gjedheve), zëjtaria, industria e përpunimit të drurit dhe industria përpunuese.

Vushtrria gjendet në mes të dy qendrave kryesore Prishtinë dhe Mitrovicë, andaj rrugët ndërlihdhëse dhe hekurudhat janë mundësi e mirë që zhvillojnë lëvizjen e shpejtë të qytetarëve dhe mallrave. Komuna gjendet në udhëkryqin e rrugës kryesore ndërkombëtare dhe regjionale dhe në udhëkryqin e arterieve hekurudhore (Adriatikut dhe Ibrit).

Vende atraktive për t'u vizituar në komunën e Vushtrrisë janë :Ura e Vjetër e Gurit, Kalaja e Qytetit, Hamami i Qytetit dhe Kompleksi Azem Bejtë Galica në Galicë.

Misioni i Komunës së Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka për mision të ngritë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, të sigurojë një jetë me të mirë për të gjithë qytetarët e saj. Të siguroj zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, avancim të arsimit dhe edukimit, përmirësim të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, zhvillim të infrastrukturës dhe ruajtjes së ambientit, promovim të turizmit, kulturës dhe sportit, rritje të efikasitetit të administratës publike.

PJESA E PARË: STRATEGJIA PËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM

PLATFORMA PËR KOMUNIKIM TË BRENDSHËM

Komunikimi i brendshëm është një komponentë e rëndësishme e institucioneve publike dhe jo vetëm, sidomos të atyre që në përbërjen dhe natyrën e vet janë më komplekse siç është rasti me administratat komunale.

Komunikimi i brendshëm luan një rol kyç në energjizimin e aktiviteteve, nismave dhe projekteve, një komunikim efikas brendapërbrenda administratës komunale do të vendoste themelet për një komunikim efikas edhe me audiencat e jashtme. Në qendër të komunikimit të brendshëm qëndron angazhimi dhe përfshirja (fizike, mendore, emocionale dhe intelektuale) e të punësuarve në aktivitetet vendimmarrëse dhe zbatuese. Me pak fjalë, parakusht për një komunikim të brendshëm efektiv është eliminimi i barrierave burokratike në vendimmarrje me synimin që të shfrytëzohet potenciali i të gjithë të punësuarve.

Komuna e Vushtrrisë beson se rritja e potencialit për të ofruar shërbime cilësore varet shumë nga mirinformimi dhe motivimi i personelit. Komunikimi i brendshëm do të shërbejë si një lokomotivë, e cila mund të bartë barrën e rritjes së rendimentit dhe performancës në njërin anë, dhe të udhëheqë me ndryshimet e domosdoshme sistemore dhe organizative në anën tjetër.

Procesi i ridizajnit të komunikimit të brendshëm është zhvilluar në mënyrë transparente, të hapur dhe me pjesëmarrjen aktive të të punësuarve përmes dy pyetësorëve gjithëpërfshirës mbi (1) kënaqshmërinë e tyre me komunikimin brenda administratës komunale dhe (2) kënaqshmërinë e tyre me kushtet e punës. Së këndejmi, të gjithë të punësuarit në administratën komunale do të kenë mundësinë të luajnë rolin e vet në këtë funksion.

Ky seksion i Strategjisë së komunikimit ka për qëllim që të vendosë premiset e komunikimit brendapërbrenda administratës komunale, sistemin dhe përgjegjësitë me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të informacionit, motivimin e personelit dhe avancimin e kushteve të punës, e për rrjedhojë edhe përmirësimin e performancës së përgjithshme në ngritjen e imazhit dhe reputacionit të organizatës. Të gjitha veprimet për komunikim të jashtëm dhe marrëdhënie me media (fushatat vetëdijesuese, dëgjimet buxhetore, dëgjimet publike, takimet konsultative me qytetarë, hartimi dhe vlerësimi i planit të transparencës, etj.) do të paraprihen nga një koordinim përfshirës brendapërbrenda administratës.

Në funksion të kësaj, objektivat kryesor të komunikimit të brendshëm në administratën komunale janë:

1. Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë.
2. Përmirësimi i kushteve të punës dhe i qasjes komunikuese.

MEKANIZMI I KOMUNIKIMIT NË TË ARDHMEN

Komunikim i brendshëm nuk është vetëm një proces i komunikimit të mendimeve, ideve apo informacioneve tek të punësuarit, por një mekanizëm në funksion të motivimit të tyre për një performancë më të mirë në arritjen e objektivave të komunës.

Është me rëndësi që në të ardhmen të administrata komunale të komunikojë përmes mjeteve dhe kanaleve që sigurojnë transmetimin e saktë dhe të kohshëm të informacioneve të gjithë të punësuarit në mënyrë efikase dhe me kosto të arsyeshme. Kabineti i Kryetarit të Komunës në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun do të vendosin dhe mirëmbajnë një sistem efikas të komunikimit dykahësh, i cili do të jetë thelbësor në rritjen e objektivave të mësipërm.

Objektivi 1: Rritja e motivimit dhe performancës të të punësuarve në administratë.

Intervenimet:

- Marrja e mendimit dhe rekomandimeve të të punësuarve dhe mbi praktikën e komunikimit dhe mbi ambientin e punës përmes bisedave të drejtpërdrejta dhe anketave vjetore.
- Organizimi i ngjarjes të funditvitit me të punësuarit në administratën komunale për t'i falënderuar (dhe shpërblyer performuesit më të mirë) për kontributin e dhënë.
- Pajisja e të punësuarve me mjete adekuate teknologjike dhe ndërhyrje në përmirësimin e kushteve të punës.
- Zbatimi efikas të programit të trajnimeve në funksion të ngritjes teknike dhe profesionale të të punësuarve
- Takimet e përgjithshme me stafin e administratës komunale (së paku dy herë në vit) për të diskutuar çështje që ndërlidhen me dhe për objektivat dhe planet e qeverisë komunale si dhe për aspektet organizative të administratës komunale (aspektet e administratës, financave, logjistikës, zhvillimit të kapaciteteve profesionale, etj.)

Këto intervenime do të shoqërohen edhe me përcjelljen konsistente të mesazheve komunikuese të cilat, mbi të gjitha, do të kenë synim arritjen e objektivave të komunikimit të brendshëm në përgjithësi, dhe rritjen e nivelit të motivimit tek të punësuarit në veçanti.

- Administrata komunale bën gjithçka që është e mundur që të jetë një ambient ku të punësuarit mbahen të informuar e dëgjohen dhe mendimet e të tyre respektohen;

Indikator	Fillestarja 2020	Synimi 2021	Synimi 2022	Synimi 2023
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se njoftohen me kohë mbi vendimet e rëndësishme të kryetarit, Kuvendit dhe Bordit të drejtorëve	36 %	45%	55%	65%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se vendimet e menaxhmentit të lartë arsyetohen në secilin rast	32 %	40%	55%	65%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht që komunikimi me eprorët dhe drejtuesit e komunës është i shkëlqyeshëm	46 %	55%	65%	70%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se komunikimi brenda ekipeve të tyre është efektiv	64 %	75%	80%	85%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se e kuptojnë çfarë pritet nga tyre për të realizuar synimet e administratës komunale	76 %	85%	88%	90%
% e të punësuarve të cilët pajtohen plotësisht se kanë të gjitha mjetet në dispozicion për kryerjen me sukses të detyrave së tyre.	42 %	50%	55%	60%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht që menaxhmenti i lartë vlerëson cilësinë e punës.	63 %	70%	75%	80%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se eprorët i falënderojnë personalisht sa herë që i tejkalojnë pritshmëritë.	51%	60%	65%	70%
% e të punësuarve që pajtohen plotësisht se ata punojnë në një ambient që u mundëson avancim në karrierë.	36 %	40%	50%	55%

PLATFORMA PËR KOMUNIKIM TË JASHTËM

Komuna e Vushtrrisë e ka për detyrë që t'i ofrojë publikut informacione mbi politikat, prioritetet, strategjitë dhe vendimet e saj. Platforma e komunës për komunikim të jashtëm mbështetet në të drejtën e qytetarëve, mediave, organizatave të shoqërisë civile, hisedarëve dhe partnerëve për qasje të lirë, të drejtë dhe të kohshme në informacionet që ndërlidhen me veprimtarinë e Komunës dhe në dokumentet zyrtare. Ndërveprimi me publikun dhe audiencat relevante do të jetë i vazhdueshëm, i hapur, gjithëpërfshirës, relevant dhe në besim reciprok.

Kjo platformë mbështetet në tre shtylla kryesore:

Konsistenca – informacione të standardit të lartë dhe të mirë-përgatitura (që bazohen në kërkesat e publikut dhe audiencave specifike) në përputhje me kulturën organizative, vlerat dhe vizionin e administratës komunale.

Besueshmëria – komuna ofron informacione të sakta dhe të kohshme që promovojnë transparencën dhe ndërveprimin me publikun dhe audiencat.

Dukshmëria - Komuna do të përkujdeset që veprimet e saj të dukshme, të qasshme dhe llogaridhënëse. Prania e Komunës do të jetë e dallueshme përmes njësive identitare të standardizuara të komunikimit, që nga ambientet në qendrën për shërbim të qytetarëve e deri te projektet kapitale të financuara nga buxheti jonë.

OBJEKTIVAT DHE INTERVENIMET SPECIFIKE

Duke u nisur nga analiza e gjendjes së përgjithshme me komunikim aktual në komunë, synimet për të avancimin e tyre në të ardhmen dhe kapacitetet financiare dhe njerëzore, Komuna e Vushtrrisë ka përcaktuar tre objektiva kryesore të cilët do të synohet të realizohen përmes kësaj strategjie:

- 1. Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje**
- 2. Promovimi i komunës dhe aktiviteteve të institucioneve komunale**
- 3. Ndërtimi identitetit vizual të komunës dhe dukshmëria e aktiviteteve**

Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje - Synimi parësor i kësaj Strategjie është që t'i mundësohet qytetarëve të komunës jo vetëm një qasje e lehtësuar në informacionet mbi aktivitete e Komunës, por edhe të nxisë përfshirjen e tyre në procesin e vendimmarrjes. Përmes kësaj strategjie Komuna kërkon të instalojë një qasje komunikimi e cila merr në konsideratë preferencat e qytetarëve dhe audiencave tjera dhe për rrjedhojë hap shtigje për ndërtimin e një klime mirëbesimi.

Promovimi i komunës dhe aktiviteteve të institucioneve komunale - do të synohet përmes paraqitjeve të strukturuar mediale, diversifikimit të kanaleve dhe materialeve komunikuese, përdorimit të shtuar të mediave të reja dhe digjitale dhe ndërveprimit të shtuar përmes faqes zyrtare të komunës në Internet. Në vitet në vijim, komuna synon që të rrisë praninë e saj në platformat sociale, si në aspektin sasior ashtu edhe ën atë cilësor. Përpara hapjes së llogarive në platformat e tjera sociale, ne do të sigurohemi që personeli në ZKP të trajnohet për përdorimin korrekt dhe efikas të tyre. Në këtë drejtim

Objektivi 3: Ndërtimi identitetit vizual të komunës dhe dukshmëria e aktiviteteve

Intervenimet:

- Përqendrim i shtuar i produkteve audio-vizuale;
- Publikime elektronike që promovojnë vlerat dhe asetet e Komunës;
- Fushata informimi për çështjet me rëndësi zhvillimore për komunën
- Prodhimi i njësive standarde të identitetit vizual të komunës
- Hartimi i Strategjisë komunale për marketing dhe brendim

KANALET E KOMUNIKIMIT

Duke marrë parasysh zhvillimet e mediave të reja dhe kërkesat e kësaj strategjie, Komuna e Vushtrrisë do të rishikojë kanalet e komunikimit me audiencat të jashtme në mënyrë që aktivitetet, nismat dhe projektet e ndërmarrja të pasqyrohen me korrektësi dhe të marrin vëmendjen e merituar të publiku. Përgjithësisht, komunikimet e Komunës me audiencat e jashtme do të kalojnë përmes kanaleve të renditura më poshtë:

Webfaqja e Komunës <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/> mbetet kanali më i rëndësishëm i komunës për komunikim zyrtar me audiencat e jashtme. Vështirësitë e hasura pas ridizajnit të faqes zyrtare të komunës po tejkalohen gradualisht dhe në muajt në vijim ajo duhet të ushqehet me informacionet relevante në funksion të informimit publik dhe qeverisjes së mirë dhe transparente.

Mediat online dhe platformat e komunikimit social - Zyra për Informim do të krijojë lista të konsoliduara për të gjitha audiencat, duke përfshirë edhe mediat tek të cilat synon që të përcjellë ngjarjet që meritojnë vëmendjen e publikut. Duke pasur parasysh rritjen gjithnjë e më të madhe të popullaritetit të mediave të reja (digjitale), komuna duhet të kërkojë për forma më efikase të komunikimit me to. Në momentin aktual, Komuna e Vushtrrisë është e pranishme vetëm në platformën sociale Facebook. Prania në platformat tjera sociale është një aspekt që do të adresohet që në vitin e parë (2021) me qëllim të hapjes së sa më shumë kanaleve të komunikimit digjital dhe përfshirjes së sa më shumë audiencave në komunikimet e ditëpërditshme.

Paraqitjet publike dhe në media – janë një formë efikase për t’iu drejtuar audiencave të ndryshme për çështje specifike dhe me rëndësi për zhvillimet në komunë. Në këtë kuadër do të intensifikohen konferencat për shtyp (të rregullta dhe të rastit), intervistat dhe debatet në media, takime jorformale me përfaqësuesit e mediave, inaugurime dhe promovim e nismave të ndryshme, shkrime autoriale dhe opinione për çështje specifike që ndërliken me qeverisjen lokale, etj.

Publikimet - janë një element aspekt kyç i punës së komunës dhe prezantimit të saj. Ana përmbajtjesore dhe vizuale e publikimeve zyrtare do të rishikohet në mënyrë që të jenë më të kuptueshme dhe

	<ul style="list-style-type: none"> Investimet kapitale në komunë planifikohen me pjesëmarrjen tuaj. Komuna shpenzon me përgjegjësi dhe efikasitet paratë e taksapaguesve dhe donatorëve. Komuna, çdo ditë e më tepër, po bën përpjekje për luftimin e korrupsionit dhe dukurive negative në shoqëri. 	<ul style="list-style-type: none"> rëndësinë e tyre për objektivat zhvillimor. Të kenë një perceptim pozitiv mbi përgjegjshmërinë dhe efikasitetin në shpenzimin e fondeve publike dhe kontributet e donatorëve dhe partnerëve. Të raportojnë veprimet abuzive dhe korrupsionin 	<ul style="list-style-type: none"> Publikimet periodike dhe të rastit
Mediat lokale nacionale	<ul style="list-style-type: none"> Administrata komunale është shumë e motivuar për të rritur cilësinë e shërbimeve. Komuna e Vushtrrisë i shpenzon paratë e taksapaguesve në mënyrë të përgjegjshme dhe në interes të zhvillimit të komunës. Jemi të hapur ndaj të gjitha interesimeve tuaja. Mbështetja juaj është e domosdoshme në luftimin e korrupsionit dhe keqqeverisjes. 	<ul style="list-style-type: none"> Të mbulojnë ngjarjet që ndërlidhen me komunën në mënyrë të kohshme, saktë, të sinqertë dhe të paanshme. Të raportojnë për nismat dhe projektet pozitive të komunës Ta konsiderojnë administratën komunale një burim të besueshëm të informacionit. Të ofrojnë kontributin e tyre në përmirësimin e cilësisë së qeverisjes 	<ul style="list-style-type: none"> Webfaqja Platformat sociale Komunikata dhe lajme Video lajme Publikimet periodike Konferenca për shtyp Takime me gazetarë Intervista Shkrime profesionale për çështje të caktuara
Organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat profesionale	<ul style="list-style-type: none"> Komuna është e hapur për bashkëpunim dhe mirëpret kontributin e OSHC-ve dhe organizatave profesionale Komuna do të mbështesë nismat dhe projektet e shoqërisë civile që kanë për synim përmirësimin e cilësisë së standardeve demokratike në komunë. OSHC-të janë një aleat i besueshëm i komunës në luftimin e 	<ul style="list-style-type: none"> Ta konsiderojnë komunën si partner të rëndësishëm në mbështetjen e nismave dhe kauzave të tyre Të marrin pjesë aktivisht në vendimmarrje. Të mbështesin përpjekjet e komunës për qeverisje gjithëpërfshirëse. Të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve komunale 	<ul style="list-style-type: none"> Webfaqja e komunës Mediat online dhe platformat sociale Takime publike, takime konsultative, dëgjime buxhetore, takimet komunitare Nisma dhe organizime të përbashkëta

- | | | |
|--|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> të forcojë sundimin e ligjit. • Komuna e Vushtrrisë i mirëpret dhe i shfrytëzon kontributet e donatorëve në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme. • Komuna e Vushtrrisë është një partner i besueshëm që kujdeset për qëndrueshmërinë e projekteve dhe investimeve. | <ul style="list-style-type: none"> grumbullimin e fondeve për qëllime zhvillimore. • Të përdorin autoritetin e tyre për më shumë fonde për komunën e Vushtrrisë. • Të mbështesin komunën në rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe demokracisë. • Të mbështesin komunën në forcimin e rendit dhe ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. | <ul style="list-style-type: none"> • Takime të rregullta bashkërenduese • Nisma dhe organizime të përbashkëta • Pjesëmarrje të rregullta në ngjarjet me relevancë për qeverisjen lokale • Publikimet periodike dhe të rastit |
|--|---|--|

PLANIFIKIMI DHE VLERËSIMI I PEFORMANCËS

Zbatimi efikas i kësaj strategjie do të mbështetet në planet vjetore të veprimit. (Shih Shtojcën 2 për planin e veprimit për komunikim të jashtëm). Vlerësimi i zbatimit të planit për komunikim të jashtëm do të bëhet mbi bazën e indikatorëve të përcaktuar më poshtë, të cilët janë specifik, të matshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm, dhe mbi të gjitha, janë burimin e kanë nga hulumtimet me qëndrueshmëri metodologjike.

Indikator	Fillestarja 2020	Synimi 2021	Synimi 2022	Synimi 2023
Vlerësimi i performancës së komunës në Indeksin e Transparencës Buxhetore (pikë) të Institutit GAP	69.5	75	78	85
% e qytetarëve të kënaqur dhe deri diku të kënaqur me shërbimet komunale në raportin e USAID: “Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik”	69%	72%	75%	78%
% e qytetarëve që kanë marrë pjesë në së paku një dëgjim publik në raportin e USAID: “Perceptimi i qytetarëve mbi korrupsionin dhe transparencën në Prokurimin publik”	3.7%	4.2%	4.5%	4.8%

ROLET DHE PËRGJEGJËSITË KYÇE

Zyrtari	Rolet dhe përgjegjësitë
Kryetari i Komunës	<p>Nxit, promovon dhe mbështetë kulturën e komunikimit të hapur dhe efikas brenda administratës komunale dhe kujdeset për një komunikim të shëndoshë me audiencat e jashtme.</p> <p>Siguron që komunikimi me të gjitha audiencat e synuara të jetë i kohshëm, i saktë, dhe në funksion të bashkërendimit efikas.</p>
Kryetari & Këshilltari për Media	<p>Mbikëqyrin zbatimin e Strategjisë për Komunikim</p> <p>Ndërmarrin veprime të konkrete me qëllim të zbatimit efikas të kësaj strategjie dhe mbikëqyrjes së saj.</p> <p>Janë përgjegjës për vlerësimin periodik (vjetor) të zbatimit të kësaj strategjie.</p>
Drejtorët e drejtorive komunale	<p>Nxisin dhe mbikëqyrin zbatimin e kësaj strategjie brenda drejtorive të tyre dhe informojnë Kryetarin dhe Nënkryetarin e komunës për progresin në zbatimin e saj.</p> <p>Furnizojnë Zyrën për Komunikim me Publikun me informacione të cilat meritojnë publicitet dhe vëmendje të publikut.</p> <p>Koordinohen me Zyrën për Komunikim me Publikun dhe me Kabinetin e Kryetarit për paraqitjet e tyre në media dhe publik.</p> <p>Informojnë personelin e drejtorive me të cilat udhëheqin me zhvillimet që ndërlidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës dhe inkurajojnë shprehjen e lirë të tyre në planifikim dhe vendimmarrje.</p>
Zyra për Komunikim me Publikun	<p>Është përgjegjëse për të mirëmbajtjen e faqes zyrtare të komunës në internet dhe llogarive në platformat sociale.</p> <p>Është përgjegjëse për informimin e saktë dhe të kohshëm përmes kanaleve të komunikimit në dispozicion të komunës.</p> <p>Kontribuon në pasurimin e formave të komunikimit dhe mbanë të informuar Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e komunikimit të jashtëm.</p> <p>Në bashkëpunim me kabinetin e kryetarit sigurohet për zbatimin e plotë të Planit të Transparencës.</p>

SHTOJCAT

Shtojca 1. Plani i veprimit për komunikim të brendshëm

AKTIVITETE TË VEÇANTA

VEPRIMI	PËRGJEGJËSIA	KOHA	KOSTOJA
Krijimi i listave të grupuara të kontakteve me audiencat për komunikim të brendshëm	Shefi i kabinetit të kryetarit dhe Zyra për Informim	Java 2 e janarit	Pa kosto shtesë
Rishikimi i zbatimit të Programit të Trajnimeve dhe Azhurnimi i databazës në nevoja për ngritje teknike profesionale	Kryetari i komunës Drejtorët e drejtorive	Java 3 e janarit	Pa kosto shtesë
Hartimi i udhëzimeve për komunikim me email me audiencat e brendshme dhe të jashtme	Shefi i kabinetit të kryetarit Zyra për Informim	Java 4 e janarit	Pa kosto shtesë
Konceptimi i formave të standardizuara të raportimit (raportimet periodike dhe raportimet për ecurinë e nismave dhe projekteve)	Shefi i kabinetit të kryetarit Zyrtari i raportimit	Java 3 dhe 4 e janarit	Pa kosto shtesë
Pilotimi/Testimi i praktikave të reja të raportimit (me përmbajtje dhe stil të ri)	Shefi i kabinetit të kryetarit Zyrtari i raportimit	Java 3 e shkurtit	Pa kosto shtesë
Zhvillimi i konceptit dhe formatit të Takimeve të Përgjithshme me Stafin (me pjesëmarrjen e të gjithë të punësuarve)	Kryetari i komunës Drejtorët e drejtorive Zyrtari për logjistikë Zyrtarët për Teknologji të Informacionit	Java 4 e shkurtit	Pa kosto shtesë
Organizimi i punëtorisë mbi praktikat e reja të raportimit dhe stilin e të shkruarit – rezultatet e pilotimit	Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive	Java 2 e prillit	Pa kosto shtesë
Takimi i Përgjithshëm me stafin e administratës	Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e personelit	Java 1 e majit	Pa kosto shtesë

AKTIVITETET E PËRSËRITURA :

AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	FREKUENCA
Takime drejtorëve të drejtorive me zyrtarët e linjës	<i>Drejtorët e drejtorive</i>	Në baza javore
Raportet e konsoliduara periodike të administratës komunale	<i>Kryetari komunës Shefi i kabinetit të kryetarit</i>	Në baza mujore
Takimet një-në-një brenda drejtorive/sectorëve	<i>Drejtorët e drejtorive komunale</i>	Sipas nevojës
Takimet e bordit të drejtorëve	<i>Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Drejtorët e drejtorive komunale</i>	Në baza javore
Takime të përgjithshme me personelin e administratës komunale	<i>Kryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit Nënkryetari i komunës Njësia e personelit</i>	Dy herë në vit
Pjesëmarrja e të punësuarve në trajnime	<i>Drejtorët e drejtorive Njësia e personelit</i>	Sipas programit dhe sipas ftesave nga organizatorët
Informim i rregullt dhe i strukturuar i të punësuarve mbi ngjarjet dhe zhvillimet që ndër lidhen me administratën komunale dhe Kuvendin e Komunës.	<i>Kryetari komunës Nënkryetari i komunës Shefi i kabinetit të kryetarit</i>	Sa herë që ka zhvillime që ia vlejné të ndahen me të punësuarit (arritje, ngjarje, këshillime, etj.)
Takimet bashkërenduese të kryetarit me kryesuesin e kuvendit dhe KPF-në	<i>Shefi i kabinetit të kryetarit Njësia e Kuvendit të Komunës</i>	Para secilës seancë dhe sipas nevojës

Kostoja provizore:
3450.00 EURO

Hartimi dhe prodhimi i fletëpalosjeve për parandalimin e korrupsionit në ofrimin e shërbimeve komunale	ZKP Koordinator i Planit të Integritetit	Mars 2021	400.00
Trajnim (në vend të punës) mbi përdorimin efikas të platformave sociale (FB, Insatgram, YouTube) për personelin e ZKP	Njësia e personelit ZKP	Mars 2021	300.00 (për trajnerin)
Takim tematik 1 i kryetarit të komunës me përfaqësuesit e mediave në formatin e sallorit	Kryetari i Komunës Kabineti i kryetarit ZKP	Mars 2021	400.00 (buffet)
Konferenca e Kryetarit të komunës për paraqitjen e Raportit Vjetor 2019	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZKP	Prill 2021	Pa kosto
Konferencat e drejtorëve të drejtorive komunale për paraqitjen e raporteve vjetore të punës.	Drejtorët e drejtorive ZKP	Prill 2021	Pa kosto
Lansimi i llogarive të reja të komunës në platformat sociale	ZKP Kabineti i Kryetarit	Maj 2021	Pa kosto
Hartimi i Planit/Kalendarit të dëgjimeve buxhetore	Kabineti i Kryetarit Kryetari i Kuvendit	Maj 2021	Pa kosto
Publikimi Broshurës elektronike “Investimet Kapitale në Komunë 2014-2020”	Kabineti i Kryetarit ZKP	Qershor 2021	600.00
Takim tematik 2-të i kryetarit të komunës në formatin e sallorit	Kryetari i Komunës Kabineti i kryetarit ZKP	Qershor 2021	400.00 (buffet)
“Dita e Dyerve të Hapura” të Kryetarit të Komunës	Kryetari i Komunës Kabineti i Kryetarit ZKP	Korrik 2021	500.00 (ujë dhe pije freskuese)

Takime të Kryetarit të
komunës me komunitetin

Kryetari i Komunës
Këshilltari për media
ZKP

Një herë në muaj

Kostoja preliminare:
7300.00 EURO

Shtojca 3. Plani i Transparencës

Shtojca 4. Plani për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje